

**AKT THEMELIMI**  
**i Shoqërisë "TIBAS" Sh.p.k.**

Sot, më datë 09/05/2024, ne Tirane, nga ortaku themelues:

**"MET INVEST" Sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NUIS L81310039M, me seli në: Rruga Ismail Qemali, Pallati 11, Kati 2, ne krah te Radio Televizionit Shqiptar, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori i shoqërisë, Z. Hauard Malo, në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ka vendosur të themelohet një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar e emërtuar **"TIBAS" Sh.p.k.** (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**

**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është **"TIBAS" Sh.p.k.**

**NENI 2**

**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Ismail Qemali, Pallati 11, Kati 2, në krah të Radio Televizionit Shqiptar, Tiranë.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

**NENI 4**

**OBJEKTI**

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Veprimtari ne sektorin e teknologjise dhe te sherbimeve me cilesine e projektimit, implementimit dhe mirembajtjes, duke kryer keto veprimtari:
- Projektim, integrim, implementim, automatizim dhe mirembajtje te sistemeve MEP (mekanike, elektriko – elektronike dhe hidraulike), sistemeve te akses-kontrollit, sistemeve te monitorimit CCTV, sistemeve te parkimit me qellimin e ofrimit te gjithë sherbimeve qe nevojiten ne qendrat e biznesit, godinat komerciale, ambjentet e banimit, etj;
- Sisteme per administrimin dhe automatizimin e proçeseve; Platforma te informatizuara dhe programe per administrimin e aktivitetit të bizneseve (ERP); Zhvillimi i softuerit (PC dhe mobile) per procesin e automatizimit dhe sistemeve te menaxhimit ne hoteleri-turizem; Sherbime te marketingut digjital;
- Organizimi dhe ofrimi i trajnimeve dhe kurseve me objekt aftesimin profesional;
- Shitja, blerja dhenia me qira e pasurive te paluajtshme; Transporti i mallrave dhe udhetareve brenda dhe jashte vendit etj.; Tregtimi i artikujve te ndryshem

- importi-eksporti shitja me shumice e pakice e pajisjeve elektrike elektronike lende te pare per industrine e ndertimit, pajisje zyresh, kancelari, etj;
- Administrimin e bashkepronesise ne ndertesa; Ofrimi i sherbimit te konsulences ne fushen e biznesit, menaxhimit te taksave, menaxhimi i ambjenteve tregtare, bareve, restoranteve, hoteleri-turizmit.
  - Shoqeria ka te drejte te kryeje cdo lloj aktiviteti te parashikuar nga ligji ne perputhje me rregullat e dispozitat ne fuqi.

## **NENI 5**

### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakut themelues në vlerën 100 000 Lek (njëqindmije) dhe është i përbërë nga 1 (nje) kuote.

Shoqeria "**MET INVEST**" **Sh.p.k**, është ortak e vetme dhe zotëron 1 kuotë, qe perben 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 100 000 Lek (njëqindmije) të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e statutit.

## **NENI 6**

### **ORGANET E SHOQËRISË**

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.
- **Z. Leonard Koçi**, shtetas shqiptar, lindur më 15.04.1972, në Orenje, banues në Tirane, mbajtës i dokumentit Kartë Identiteti me nr. Personal H20415277G, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administrator për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## **NENI 7**

### **LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM**


Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## **NENI 8**

### **DISPOZITA FINALE**

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë, duke autorizuar **Administratorin Z. Leonard Koçi** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.



**ORTAKU THEMELUES**  
**"MET INVEST" Sh.p.k**  
**Përfaqësuar nga**  
**Hauard Malo**

